

KONTRATA SOCIALE KAMËZ

RAPORT MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE SHTATOR 2021-SHTATOR 2022

Viti i III-të i monitorimit

PËRGATITUR NGA:
SHOQATA PËR INTEGRIMIN E ZONAVE INFORMALE

**KONTRATA SOCIALE
BASHKIA KAMËZ**

**RAPORTI MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE
VITI I III-TË I MONITORIMIT**

**POP – PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE
SHTATOR 2021 – SHTATOR 2022**

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioritetëve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP 2019, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Center në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social” dhe National Endowment for Democracy.

Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra “Aleanca Gjimore për Zhvillim”, Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë,
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz;
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec;
- Gruaja në Zhvillim, Korçë;
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
- Tjetër Vizion, Elbasan

Ky Raport është Përgatitur nga Shoqata për Integrimin e Zonave Informale në kuadër të projektit POP 2022 “Monitorimi i zbatimit të kontratës sociale në nivel lokal” dhe nuk përfaqëson qëndrimin e Olof Palme International Center dhe National Endowment for Democracy. Gjetjet dhe qëndrimet në raport janë përgjegjësi vetëm e autorëve.

Tabela përmbledhëse

| | |
|--|-----------|
| Shkurtime | 5 |
| Falenderime | 5 |
| Hyrje | 6 |
| Metodologjia | 8 |
| Përmbledhje Ekzekutive | 9 |
| Analiza e gjetjeve sipas Kontratës Sociale | 10 |
| Prioritet 1: Zhvillimi i incentivave për nxitjen e biznesit duke reduktuar taksat për bizneset e reja që hapen nga të rinjtë me qëllim krijimin e vendeve të reja të punës. | 10 |
| Prioritet 2: Krijimi i lehtësirave në nivelin e taksave / tarifave lokale për kategoritë në nevojë. | 11 |
| Prioritet 3: Adresimi me prioritet i rregullimit të ndriçimit dhe mirëmbajtjes në Njësinë Administrative Paskuqan..... | 11 |
| Prioritet 4: Kontrolli më i shpeshtë i shërbimit të Pastrimit | 12 |
| Prioritet 5: Investimi në ngritjen e kopshteve dhe çerdheve të reja në Nj. A. Bathore dhe Paskuqan | 12 |
| Prioritet 6: Adresimi me prioritet dhe zgjidhja e problemeve me kanalizimet në Bathore, prioritet në lagjet 3 dhe 4 | 13 |
| Prioritet 7: Investimi dhe adresimi për përmirësimin e rrugëve, trotuareve dhe sinjalistikës në Nj. A. Paskuqan me një fokus të veçantë në rrugët e brendshme dhe dytësore | 14 |
| Prioritet 8: Ngritja e politikave lokale për përfshirjen e të rinjve në vendimmarrje. Ngritja e Këshillit Rinor pranë Këshillit Bashkiak..... | 15 |
| Prioritet 9: Informimi i komunitetit në lidhje me shërbimet e kujdesit shoqëror për grupet në nevojë. Përmirësimi i shërbimeve sociale pranë Njësi Administrative 16 | |
| Legjenda e adresimit të prioriteteve | 17 |
| Rekomandime | 19 |
| Gjetjet nga Raporti i Pare i Monitorimit të Kontratës Sociale: | 20 |
| Gjetjet nga raporti i Dytë i Monitorimit të Kontratës Sociale: | 22 |
| Referenca | 24 |
| Aneks – Kontrata Sociale Kamëz | 26 |

Shkurtime

| | |
|-------------------------------|--|
| Nj. A. | Njësi Administrative |
| NE | Ndihmë Ekonomike |
| VKB | Vendim i Këshillit Bashkiak |
| VKM | Vendim i Këshillit të Ministratave |
| POP | Përballja e Ofertave Politike |
| Kontrata Sociale ¹ | 9 prioritetet kryesore të identifikuara nga banorët gjatë 2019 |

Falenderime

Për të hartuar këtë raport bashkëpunuam me shumë aktorë e institucione. Falenderojmë qytetarët e angazhuar, Bashkinë Kamëz, si dhe Institucionet dhe individët/ekspertët, për përgjigjen e shpejtë, cilësore brenda afatit kohor.

Falenderojmë veçanërisht të rinjtë dhe qytetarët që pranuan ti përgjigjeshin pyetjeve tona, anëtarët e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) të cilët si ne po bëjnë një punë shumë të mirë pranë territoreve ku operojnë në ndihmë të komunitetit.

Gjithashtu dëshirojmë të falenderojmë **Olof Palme International Center** dhe **National Endowment for Democracy - NED** për ndihmën teknike e financiare, pa të cilët do të ishte e pamundur të hartohej ky raport dhe të realizoheshin aktivitete të ndryshme nga Rrjeti POP.

¹ <https://popnetwork.al/kontrata-sociale-me-prioritetet-kryesore-kamez/>

Hyrje

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët, si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë vendore, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Gjatë vitit 2019 janë hartuar kontratat sociale për 9 bashki (Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Kamëz, Pogradec dhe Pukë), ndërsa tre bashki të reja u bënë pjesë e këtij procesi në vitin 2021, përmes replikimit të procesit edhe në bashkitë e Elbasanit, Vau i Dejës dhe Korçë duke e çuar në 12 numrin e bashkive nën monitorimin e organizatave të shoqërisë civile anëtare të rrjetit POP. Gjatë periudhës shtator 2021-2022 për të tretin vit me rradhë, rrjeti POP monitoroi zbatimin e tyre përmes dy projekteve që shkrihen te njëri – tjetri të financuara nga Olof Plame International Centre (OPIC) dhe National Endowment for Democracy (NED).

Ky është viti i tretë i monitorimit të punës së pushtetit vendor për përfshirjen e prioriteteve të qytetarëve dhe përmbushjen e Kontratës Sociale.

Kontrata Sociale në Kamëz² përmban 9 prioritete që qytetarët e Kamzës identifikuan në zgjedhjet lokale të 2019. Shoqata për Integrimin e Zonave Informale (SHIZI), synoi të krijojë dhe promovojë mekanizma qytetarë në funksion të përmirësimit të demokracisë lokale, duke angazhuar qytetarët, partitë politike, kandidatët për deputetë në zgjedhjet parlamentare të 2021, stafin e Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak të dialogojnë dhe të punojnë për realizimin e prioriteteve të Kontratës Sociale. SHIZI mundësoi vlerësimin dhe monitorimin e performancës së administratës lokale dhe të zgjedhurve vendorë duke promovuar dialog dhe bashkëpunim në nivel vendor. Në Bashkinë Kamëz, Kontrata Sociale bëri që komuniteti të ketë një mjet për të mbajtur stafin e bashkisë dhe Këshillin e Bashkiak përgjegjës për adresimin e tyre, por duke përdorur edhe zgjedhjet parlamentare të 2021, advokoi me të gjitha partitë politike dhe kandidatët e tyre për të futur në agjendat politike edhe prioritetet e Kontratës Sociale.

Në vitin e parë të monitorimit të kontratës sociale për bashkinë Kamëz, 60 % e prioriteteve të qytetarëve u adresuan. Gjatë vitit të dytë të monitorimit për përmbushjen e kontratës sociale, bashkia Kamëz arriti të adresonte 80% të prioriteteve të kësaj kontrate.

Raporti i vitit të parë³ monitorues dhe raporti i vitit të dytë⁴ monitorues janë ndarë gjerësisht me përfaqësues të bashkisë si edhe me qytetarët duke analizuar arritjet por edhe punën që duhet bërë për përmbushjen e atyre prioriteteve që janë adresuar pak

² <https://popnetwork.al/kontrata-sociale-me-prioritetet-kryesore-kamez/>

³ <https://popnetwork.al/raporti-nje-vjecar-kontrata-sociale-bashkia-kamez/>

⁴ https://popnetwork.al/kamez_raporti-monitorues-shtator-2020-shtator-2021-kontrata-sociale/

dhe kanë nevojë për një vëmendje më të shtuar të pushtetit vendor. Çështja kryesore që organizata dhe rrjeti po llojnë së bashku me qytetarët: Përmirësimi i shtetit të ndërcimit. Ky prioritet është fokusi kryesor në vijim të monitorimit për zbatimin e Kontratës Sociale.

Për të mbërritur në vitin e tretë të monitorimit, gjatë vitit 2022, projekti vazhdoi me “Kontrata Sociale si mjet efektiv për pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje në nivel vendor dhe transparenca”, duke vijuar monitorimin dhe bashkëpunimin mes aktorëve kryesorë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve.

Ky raport vlerëson progresin e bërë në realizimin e prioriteteve të Kontratës Sociale për periudhën Shtator 2021 – Shtator 2022.

Gjatë vitit të tretë të monitorimit Organizata kishte si qëllim:

- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e Bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të adresimit të prioriteteve të Kontratës Sociale;
- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e Bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të fatkeqësisë natyrore për shkak të pandemisë;
- Të raportojë gjetjet dhe rekomandimet;
- Të llojë dhe advokojë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve, sidomos në kuadër të dimensionit social, transparençës dhe llogaridhënies.
- Të përdorë gjetjet e Raportit studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik nga pushteti vendor”⁵ për angazhimin dhe informimin e qytetarëve
- Angazhimin e grupeve qytetare në fushata advokimi dhe lobimi për përmbushjen e prioriteteve të Kontratës Sociale.

⁵ <https://popnetwork.al/raporti-studimor-informimi-njoftimi-dhe-konsultimi-publik-bashkia-kamez/>

Metodologjia

Për të realizuar raportin, SHIZI, anëtare e rrjetit POP u bazua në hapat e mëposhtëm:

- U monitorua puna e Bashkisë Kamëz dhe vendimet e Këshillit Bashkiak për periudhën Shtator 2021 – Shtator 2022;
- U dërgua një letër-kërkesë me email për informacion specialistit të informimit;
- U realizuan fokus-grupe me anëtarë të komunitetit në Njësitë Administrative të Kamzës, me pjesëmarrës të cilët kanë qenë pjesë e aktiviteteve të mëparshme dhe kanë kontribuar në përcaktimin e prioriteteve të Kontratës Sociale si edhe në monitorimin e saj gjatë vitit të parë.
- U monitorua në vazhdim puna e Këshillit Bashkiak Kamëz, mbledhjet e organizuara gjatë pandemisë si edhe mbledhjet në vend.
- U monitoruan vendimet e Këshillit të Bashkisë Kamëz.
- U monitoruan takimet e ndryshme të përfaqësuesve të Bashkisë përmes TV dhe medias sociale.
- U monitoruan vendimet e Këshillit Bashkiak mbi masat e marra nga vetë Bashkia, në lidhje me komunitetin në përgjithësi dhe me disa target-grupe në veçanti, si dhe veprimtaria e anëtarëve të Këshillit Bashkiak.
- U analizua dhe monitorua buxheti i bashkisë për vitit 2021 – 2022 si dhe shpenzimet respektive bazuar në open-data;
- U monitoruan dhe analizuan vendimet e KB që kanë lidhje me prioritetet e Kontratës Sociale bazuar në punën e rrjetit POP apo edhe nga faktorë të tjerë të jashtëm, të tipit: parashikime të mëhershme në buxhet, plane afatshkurtra apo/dhe afatgjata, puna e organizatave të tjera të cilat mund të kenë ndikuar në përmbushje (organizata qeveritare, organizata ndërkombëtare me projekte apo edhe kombëtare).
- Analizimi i monitorimit të mediave audiovizive dhe on line, në lidhje me sa më sipër sipas fushave specifike.

Përmbledhje Ekzekutive

Nga monitorimi i punës së Bashkisë Kamëz gjate periudhës shtator 2021 – shtator 2022 mbi adresimin e prioriteteve të Kontratës Sociale dolën këto gjetje:

- Gjatë vitit të tretë Bashkia ka vijuar me po te njejtat politika lehtësuese për bizneset e reja të hapura nga të rinjtë. Gjatë vitit të parë dhe të dytë të monitorimit, Bashkia Kamëz zhvilloi incentiva për nxitjen e biznesit duke reduktuar me 50% taksat për bizneset e reja që hapen nga të rinjtë me qëllim krijimin e vendeve të reja të punës, si dhe ka përjashtuar nga tarifat vendore të çdo subjekti të ri që hapet në territorin e bashkisë.
- Bashkia Kamëz në paketën fiskale të vitit 2020 ka të miratuar ndryshime në nivelin e taksave/tarifave lokale për kategoritë në nevojë duke aplikuar një ulje deri në 70%.
- Gjate këtyre tre viteve të monitorimit janë kryer disa investime në sistemin e ndriçimit në Njësinë Administrative Paskuqan dhe në mirëmbajtjen e ndriçimit për rrugën “Demokracia”, dhe në mirëmbajtjen e ndriçimit në disa rrugë dhe sipas banorëve këto investime kanë përmirësuar cilësinë e jetës. Banorët kërkojnë futjen në istën e investimeve për sisteme ndricimit edhe rrugët dytësore.
- Në Nj. A. Paskuqan, Bashkia ka kryer investime për shtimin e numrit të koshave të mbeturinave në 5 zona, ndërsa në Bathore ky investim është shtrirë në lagjet 1, 2, 5, 6 dhe 7. Megjithë investimet e kryera banorët kërkojnë shtrirjen e këtyre investimeve edhe në shtimin e frekuencës së pastrimit. Nderkohe frekuenca e pastrimit kerkohet tëjete më e shpeshtë.
- Me investim të qeverisë Shqiptare, në kuadër të programit të rindërtimit ka përfunduar puna për ndërtimin e 7 kopshteve dhe 5 cerdheve në Paskuqan dhe Bathore. Këto investime ne rikonstruksion dhe ndertim nga e para e këtyre institucioneve arsimore ndikojnë në përmirësimine kushteve të jetesës së këtyre banorëve.
- Gjatë vitit të tretë të monitorimit ëshë vijuar me investime në lagjet 4 dhe 5 në Bathore të cilat i shtohen investimeve 1,3,4,5 dhe 6.
- Në Nj. A. Paskuqan kanë vijuar investimet e nisuar gjatë vitit të parë në përmirësimin e infrastrukturës rrugore në disa segmente dhe është investuar në mirëmbajtjen e tyre.
- Që në vitin 2020, në Bashkinë Kamëz është ngritur Këshilli Rinor mbi bazën e ligjit për rininë, i përbërë nga nxënës të shkollave të mesme. Sipas takimeve me të rinjtë, banorë të Kamzës, atë kërkojnë që ky Këshill të vijojë të funksionojë si dhe zhvillimin e politikave rinore të qëndrueshme dhe krijimin e kushteve dhe një mjedisi të sigurt social, shëndetësor dhe politik, për të rinjtë.

- Informimi i komunitetit në lidhje me shërbimet sociale bëhet nëpërmjet afishimit në sportelet dhe ambientet e bashkisë, nëpërmjet vizitave në familje dhe telefonatave e gjithashtu nëpërmjet faqes zyrtare të Bashkisë në rrjetet sociale. Banorët kërkojnë përmirësimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë.

Analiza e gjetjeve sipas Kontratës Sociale

Ky raportim është bazuar në përgjigjet e kërkesës për informacion që SHIZI i ka dërguar Bashkisë Kamëz, në monitorimin në terren të aksioneve dhe punës së bashkisë, monitorimin e mediave si dhe në informacionet e mbledhura nga takimet me qytetarë të njësive administrative të bashkisë Kamëz.

Nga analizimi i këtyre të dhënave rezulton se Bashkia Kamëz ka adresuar prioritetet si më poshtë:

Prioritet 1: Zhvillimi i incentivave për nxitjen e biznesit duke reduktuar taksat për bizneset e reja që hapen nga të rinjtë me qëllim krijimin e vendeve të reja të punës.

Për nxitjen e bizneseve të reja të hapura nga të rinjtë Bashkia Kamëz ka ndërmarre disa iniciativë që kanë të bëjnë me reduktimin e taksave lokale. Në paketën fiskale të vitit 2022 janë miratuar disa i vendime të cilat i vijnë në ndihmë bizneseve të reja si zerimi i tarifave për çdo biznes të ri të hapur në vitin 2022 dhe zerimin për çdo biznes të drejtuar nga gratë kryefamiljare:

- 0 tarifa ndaj Bashkisë Kamëz për çdo biznes të ri që hapet në vitin 2022.
- Ulje e tarifave për biznesin e vogël.
- Ulja e tarifës së pastrimit
- Ulja e tarifës së gjelbërimit
- Ulja e tarifës së ndriçimit

Sipas përgjigjes së bashkisë në lidhje me kërkesën për informacion, Bashkia Kamëz raporton se nismat që ajo ka ndërmarrë për nxitjen e bizneseve kanë të bëjnë me përjashtimin nga tarifat vendore të çdo subjekt të ri që hapet në territorin e bashkisë.

Sipas bashkisë, gjatë vitit 2022 janë hapur 89 biznese të reja nga të rinjtë (nën 26 vjeç) nga 376 biznese të reja në total.

Ndërkohë Bashkia Kamëz mbështet dhe nxit çdo nisem nga organizata apo institucione tëndryshme që kanë për qëllim mbështetjen dhe nxitjen e bizneseve të reja nga të rinjtë: Falë bashkëpunimit me CARITAS, gjatë vitit 2022, 9 të rinj në Bashkinë Kamëz kanë marrë trajnime dhe fond 5000 euro për hapjen e biznesit të tyre.

Në bazë të raportimeve të bashkisë dhe përgjigjeve që kemi marrë nga qytetarët, rezulton se **prioriteti 1** i Kontratës Sociale Kamëz është **adresuar**, me reduktimin e tarifave lokale për bizneset e reja që hapen nga të rinjtë.

Prioritet 2: Krijimi i lehtësirave në nivelin e taksave / tarifave lokale për kategoritë në nevojë.

Në buxhetine vitit 2022 Bashkia Kamëz ka miratuar disa vendime në lidhje me niveline taksave të cilat prekin kategoritë në nevojë: që përfshijnë tek familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike, pensionistët, të pamundurit, sidhe nxënësit. Disa nga lehtësirat e përfshira në paketën fiskale 2022 janë:

- 0 tarifa ndaj Bashkisë Kamëz për bizneset e drejtuara nga kryefamiljaret femra.
- Ulje e tarifave familjare për pensionistët.
- Shpërblimin 3.000 lekë për nxënësit ekselentë të arsimit 9vjeçar.
- Shpërblimin 5.000 lekë për nxënësit ekselentë të arsimit të mesëm.
- Shpërblimin 5.000 lekë për të gjithë nxënësit me status jetim.
- Heqje e tarifës së gjelbërimit për ndërtimet e reja nga qytetarët.
- Heqje e tarifave familjare për personat e paaftë.
- Heqje e tarifave familjare për personat të cilët trajtohen me ndihmë ekonomike.

Sipas raportit të parë të monitorimit të Kontratës Sociale Kamëz, rezulton se **prioriteti 2** i kësaj kontrate **është adresuar**, me reduktimin e tarifave lokale për kategoritë në nevojë.

Prioritet 3: Adresimi me prioritet i rregullimit të ndriçimit dhe mirëmbajtjes në Njësinë Administrative Paskuqan.

Sipas monitorimit në terren dhe përgjigjes së marrë nga Bashkia, janë kryer disa investime në sistemin e ndriçimit, përkatësisht në rrugët:

- “Skavicë”,
- “Xhorxh Ë Bush”,
- “OSBE”,
- “Deja”,
- “Orikum”,
- “Arben Broci”,
- “Hasan Zylfia”,
- “Halim Xhelo”,
- “Bilal Xhaferri”.

Ndërkohë, për periudhën në vijim janë planifikuar investime në Babrru Shpat, Nj. A. Paskuqan. Sipas banorëve këto investime kanë përmirësuar cilësinë e jetës duke i bërë ato më të sigurta dhe më të aksesueshme. Megjithatë, në Paskuqan ka nevojë të vijohet me përmirësimin e shërbimit të ndricimit të rrugëve dytësore.

Në bazë të raportimeve të bashkisë dhe përgjigjeve që kemi marrë nga qytetarët, rezulton se **prioriteti 3** i Kontratës Sociale Kamëz është **adresuar**, dhe ka nevojë të vijohet me investimet e nisura.

Prioritet 4: Kontrolli më i shpeshtë i shërbimit të Pastrimit

Kontrolli më i shpeshtë i shërbimit të Pastrimit në Nj. A. Paskuqan, në të dyja lagjet, shtimi i numrit të koshave në Bathore dhe Paskuqan si dhe shtimi i frekuencës së mbledhjes nga makinat e grumbullimit në të gjithë Bashkinë Kamëz.

Bashkia ka kryer investime për shtimin e numrit të koshave të mbeturinave si dhe të frekuencës së grumbullimit të tyre, konkretisht në zonën e Paskuqan 1 dhe Babrru (Nj.A.Paskuqan) si dhe në lagjet 5,7 (Bathore)., të cilat i shtohen investimeve të kryera në zonat Kodër e Kuqe, Babrru Qendër dhe Paskuqan 2, gjatë 2 viteve të para të monitorimit.

Banorët shprehen se këto investime kanë përmirësuar shërbimin e pastrimit në këto zona. Ndërkohë, ata shprehen se ka përmirësim në shërbimin e pastrimit të ambjenteve publike.

Sipas monitorimit të kryer gjatë vitit të dytë të raportimit, prioriteti 4 rezulton **i adresuar**, dhe ka nevojë të vijohet me investimet e nisura në shtimin e koshave të mbeturinave dhe përmirësimin e sistemit të pastrimit.

Prioritet 5: Investimi në ngritjen e kopshteve dhe çerdheve të reja në Nj. A. Bathore dhe Paskuqan

Investimi në ngritjen e kopshteve dhe çerdheve të reja në Nj. A. Bathore dhe Paskuqan si dhe largimi i kopshteve nga ambientet e shkollave. Në bashkinë kamëz kanë përfunduar 8 kopshte dhe 4 çerdhe. Në qendrën administrative Bathore janë ndërtuar 3 kopshte ku kanë përfituar 610 fëmijë.

Në këtë njësi administrative është larguar nga ambientet e shkollës kopshti “Gjeniu i Vogël”.

Në njësinë administrative Paskuqan janë ndërtuar 2 kopshte ku përfitojnë 445 fëmijë dhe 1 çerdhe ku përfitojnë 85 fëmijë.

Në total numri i fëmijëve që përfitojnë nga këto investime është 2650 fëmijë.

Ndërkohë janë në projekt edhe 3 kopshte të tjera.

Gjatë 3 viteve të monitorimit të Kontratës Sociale Kamez janë rindërtuar nga e para 5 kopshte:

- Kopshti “Lulet e Jetës”, Bathore;
- Kopshti “Gjeniu i Vogël”, Bathore;
- Kopshti “Xixëllonjat”, Valias;
- Kopshti “Borëbardha”, Paskuqan 1;
- Kopshti “Lule Dielli”, Laknas.

Si dhe rikonstruksionin total të 4 kopshteve:

- Kopshti “Zarife Hasanaj”, Paskuqan;
- Kopshti “Bletëzat”, Kamza e Re;
- Kopshti “Topolino”, Zall Mner;
- Kopshti “Bota e Luleve”, Bathore;

Gjithsej, 11 kopshte me standarte dhe kushte, të cilat ofrojnë ushqim, fjetje dhe sisteme ngrohëse, për fëmijët.

Ndërkohë janë investuar në 4 çerdhe publike:

- Rindërtim çerdhja “Hapat e Parë”, në Babrru;
- Çerdhja “Diell”, në Qendër Kamëz,
- Çerdhja në Paskuqan;
- Çerdhja “Drita” në Valias.

Ka filluar puna për ndërtimin e:

- Çerdhja “Demokracia”

Nga vëzhgimet në terren si dhe nga përgjigjet e marra prej banorëve, ndërtimi i këtyre kopshteve ka ndikar pozitivisht në plotësimin e nevojave të komunitetit të këtyre zonave.

Me këto investime shtohen kapacitetet për mbulimin e nevojës së familjeve për kopshte në Paskuqan dhe Bathore. Në bazë të raportimeve të bashkisë dhe përgjigjeve që kemi marrë nga qytetarët, me përfundimin e punës edhe në kopshtet dhe çerdhet e tjera rezulton se **prioriteti 5** i Kontratës Sociale Kamëz është **adresuar**.

Prioritet 6: Adresimi me prioritet dhe zgjidhja e problemeve me kanalizimet në Bathore, prioritet në lagjet 3 dhe 4

Nga monitorimi i punës së bashkisë Kamëz raportohet se për përmirësimin e sistemit të kanalizimeve në Bathore, gjatë këtij viti monitorimi janë kryer disa investime për përmirësimin e këtij shërbimi përkatësisht në lagjet 4 dhe 5 që prekin rreth 110 familje.

Gjatë vitit 2022 janë kryer investimet: -Rruget e investuara nga U.K.K për përmirësimin e sistemit të kanalizimeve në Bathore janë :

- Kuvendi I
Gjirokastres,
- Kuvendi i Greces,
- Kuvendi Junikut,
- Hetem Gerbolli dhe Kryevidh

Ndërkohë nga banorët kërkohet cilësi në kryerjen e këtyre investimeve dhe shtrirja e tyre në të gjithë Bathoren. Gjithashtu, banorët shprehin shqetësimin e tyre në kohëzgjatjen e kryerjes së këtyre punimeve dhe cilësisë së tyre.

Nga monitorimi i deritanishëm rezulton se **prioriteti 6** i Kontratës Sociale Kamëz është **adresuar**, dhe ka nevojë të vijohen investimet.

Prioritet 7: Investimi dhe adresimi për përmirësimin e rrugëve, trotuareve dhe sinjalistikës në Nj. A. Paskuqan me një fokus të veçantë në rrugët e brendshme dhe dytësore

Investimi dhe adresimi për përmirësimin e rrugëve, trotuareve dhe sinjalistikës në Nj. A. Paskuqan me një fokus të veçantë në rrugët e brendshme dhe dytësore. Sipas përgjigjes së marrë nga Bashkia, kanë nisur investimet në përmirësimin e infrastrukturës rrugore⁶ në Nj. A. Paskuqan, përkatësisht:

| Nr. | EMERTIMI I RRUGES | VENDI KU NDODHET |
|-----|---|------------------|
| 1 | Rrug Sado Koshenko (Babrru Qender) | Babrru Qender |
| 2 | Rruget Zija Kambo + Zylyftar Veleshnja+Rruga Zonja Çurre +Zef Serembe + Rrugicat e Themistokli Germenji + Rrugicat Tajar Zavalani + Rruga Tom Kola + trotuaret Zef Serembe + Vazhdimi i Ziguri Lelo | Babru Shpat |
| 3 | Rruga Sulejman Vuciterna +Sulejman Pash Ballgjini + Pjeter Arbrori + Sef kosharja + Ukshin Hoti+ Rruga Sef Kosharja + Rruga Maçet + Rruga Sali Vranishti , | Babru Shpat |
| 4 | Rruga tek Cerdhja e Re,Shkolla Isa Boletini | Paskuqan 2 |
| 5 | Rruga "Haki Taha" | Paskuqan 1 |
| 6 | Rruga Josef Marksel | Paskuqan 1 |
| 7 | Rruga Isa Boletini | Paskuqan 1 |
| 8 | Blloku I Pallateve | Paskuqan 1 |

⁶ https://kamza.gov.al/wp-content/uploads/2021/02/BUXHETI_2021-1.pdf

| | | |
|----|---|---------------------------------------|
| 9 | Pedonale | Paskuqan |
| 11 | Rrugët Ahmet Zogu ,Leka Zogu Vresht | Paskuqan 2 Vresht |
| 12 | Rrugët Abdyl Elmazi + Ali Kelmendi Paskuqan Vresht ;Rrugët Xheladin Beqiri + Papa Gjon Pali II ,Fush-Kerçik + Rruga Asim Vokshi Babrru Shpat +Vaso Pasha+ | Paskuqan 2 Vresht ,Fush- Kerçik |
| 13 | Rruga UNAZA E PASKUQANIT(BESIM CERA) | Paskuqan 2 |
| 14 | Rruga DRINI | Paskuqan 2 |

Në të gjitha rrugët e lartpërmendura është vendosur sinjalistika rrugore si dhe është investuar për zgjerim trotuaresh, kanalizime, ndricim.

Investimet ne vendosjen e kangjellave: në Babrru qender, rruga Demokracia, rruga Azem Hajdari + Lidhja e Prizerenit).

Përmisimi në ndricim dhe sinjalistikë: (unaza e Paskuqanit, rruga Drini, rruga Haki Taha, rruga tek cerdhja,rruga Josef Marksel, blloku Babrru Shpat 1, blloku Babrru shpat 2, 3 rrugët tek blloku i pallateve).

Përfundimi i këtyre investimeve adreson prioritetin nr. 7 të Kontratës Sociale në lidhje me përmirësimin e infrastrukturës rrugore në Nj. A. Paskuqan.

Ndërkohë nga banorët kërkohet cilësi në kryerjen e këtyre investimeve dhe shtrirja e tyre edhe në zona të tjera të Paskuqanit, kryesisht në rrugët dytësore. Gjithashtu, banorët shprehin shqetësimin e tyre në lidhje me sinjalistikën rrugore, e cila do çojë në rritjen e sigurisë në rrugë. Banorët kërkojnë që rrugët (aty ku është e mundur) të kenë troturare sipas standardeve, ndriçim, si dhe sinjalistikë rrugore.

Nga monitorimi i deritanishëm rezulton se **prioriteti 7** i Kontratës Sociale Kamëz është **adresuar**, dhe ka nevojë të vijohen investimet.

Prioritet 8: Ngritja e politikave lokale për përfshirjen e të rinjve në vendimmarrje. Ngritja e Këshillit Rinor pranë Këshillit Bashkiak

Sipas përgjigjes së marrë nga Bashkia, më datë 18.11.2020⁷ është ngritur Këshilli Rinor pranë Bashkisë Kamëz.

⁷ <https://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-kamez-nr-137-date-18-11-2020/>

Gjatë vitit 2022 ka vijuar puna përzgjerimin e Këshillit Rinor duke përfshirë të rinjtë e komunitetit të Kamëz⁸. Janë organizuar trajnime të ndryshme në bashkëpunim me OJF-të të ndryshme; Janë zhvilluar mbledhje dhe takime për të diskutuar mbi prioritetet, nevojat dhe aktivitetet që do të realizohen dhe parashikohen në projekt-buxhetin e vitit 2023; Janë organizuar aktivitete të ndryshme gjithëpërfshirëse si takim me Kryetarin e Bashkisë dhe Kryetaren e Kuvendit; Takime mes të rinjve për të diskutuar mbi aktivitetet të ndryshme; -Hapja e rrjetit social në aplikacionin Instagram, për të promovuar çdo aktivitet të kryer më të rinjtë⁹:

Ndërkohë Bashkia ka përfshirë të rinjtë në aktivitetet e saj: Pjesëmarrës në realizimin e aktiviteteve sociale, artistike, kulturore, mjedisore etj¹⁰; Pjesëmarrje në projekte dhe trajnime për të rinjtë¹¹;

Sipas takimeve me të rinjtë, banorë të Kamzës, ata kërkojnë që ky këshill të vijojë të jetë funksional dhe të ketë vijueshmëri në mënyrë që të përçojë zërin e tyre në politikëbërje. Ndërkohë, ata kërkojnë edhe zhvillimin e mëtejshëm të politikave rinore që kanë të bëjnë me arsimin, punësimin, pjesëmarrjen në vendimarrje, kulturën, çështjet sociale etj.

Nga monitorimi dhe raportimi i të rinjve ky prioritet është **adresuar**, por ka nevojë për zhvillimin e politikave rinore të qëndrueshme dhe krijimin e kushteve dhe një mjedisi të sigurt social, shëndetësor dhe politik për ta.

Prioritet 9: Informimi i komunitetit në lidhje me shërbimet e kujdesit shoqëror për grupet në nevojë. Përmirësimi i shërbimeve sociale pranë Njësi Administrative

Sipas përgjigjes së Bashkisë, në Kamëz janë kryer mjaft aksione dhe veprime për informimin e komunitetit në lidhje me shërbimet e kujdesit shoqëror. Informimet e qytetarëve për shërbimet sociale bëhen nëpërmjet faqes zyrtare të bashkisë, afishimeve të shkresave të ndryshme në këndin e caktuar, nëpërmjet sporteleve ku sqarohen qytetarët. Janë zhvilluar edhe takime online për informimin për shërbimet ndaj kontigjenteve të caktuara dhe nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta në komunitet e në shkollë duke respektuar masat anti

Megjithëse nga monitorimi i kryer është konstatuar se mjetet e informimit të qytetarëve janë përshtatur me situatën pandemike apo edhe me teknologjinë, banorët shprehen se nuk kanë dijeni për shërbimet sociale të ngritura për individët në nevojë. Nga takimet, banorët kërkojnë përmirësimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë.

⁸ <https://kamza.gov.al/formular-aplikimi-per-te-rinjte/> -Organizimi i aktiviteteve, workshop-eve/

⁹ https://www.instagram.com/keshilli_rinor_kamez/?igshid=YmMyMTA2M2Y%3D

¹⁰ https://www.facebook.com/people/Nj%C3%ABsia-e-Integrim-it-Evropian-Bashkia-Kam%C3%ABz/100064927352662/?ref=hf&hc_ref=ARQ3NnNF8H0Wsw8bpk0BF9-TY2Af1OM8LGkKH_pl7KsE7UQl7kaFjTivfCDokmd0E78

¹¹ https://www.instagram.com/integrimi_ne_be_bashkia_kamez/

Legjenda e adresimit të prioriteteve

| Prioriteti | Viti i parë i monitorimit | Viti i dytë i monitorimit | Viti i tretë i monitorimit |
|---|---------------------------|---------------------------|----------------------------|
| Prioritet 1: Zhvillimi i incentivave për nxitjen e biznesit duke reduktuar taksat për bizneset e reja që hapen nga të rinjtë me qëllim krijimin e vendeve të reja të punës. | Adresuar 70% | Adresuar 80% | Adresuar 90% |
| Prioritet 2: Krijimi i lehtësirave në nivelin e taksave / tarifave lokale për kategoritë në nevojë | Adresuar 100% | Adresuar 100% | Adresuar 100% |
| Prioritet 3: Adresimi me prioritet i rregullimit të ndriçimit dhe mirëmbajtjes në Njësinë Administrative Paskuqan. | Adresuar 50% | Adresuar 70% | Adresuar 80% |
| Prioritet 4: Kontrolli më i shpeshtë i shërbimit të Pastrimit në Njësinë Administrative Paskuqan, në të dyja lagjet, shtimi i numrit të koshave në Bathore dhe Paskuqan si dhe shtimi i frekuencës së mbledhjes nga makinat e grumbullimit në të gjithë Bashkinë Kamëz | Adresuar 50% | Adresuar 70% | Adresuar 80% |
| Prioritet 5: Investimi në ngritjen e kopshteve dhe çerdheve të reja në Njësitë Administrative Bathore dhe Paskuqan si dhe largimi i kopshteve nga ambientet e shkollave. | Adresuar 50% | Adresuar 80% | Adresuar 100% |

| | | | |
|--|-------------------------|-------------------------|-------------------------|
| <p>Prioritet 6: Adresimi me prioritet dhe zgjidhja e problemeve me kanalizimet në Bathore, prioritet në lagjet 3 dhe 4</p> | <p>Adresuar 30%</p> | <p>Adresuar 60%</p> | <p>Adresuar 80%</p> |
| <p>Prioritet 7: Investimi dhe adresimi për përmirësimin e rrugëve, trotuareve dhe sinjalistikës në Njësinë Administrative Paskuqan me një fokus të veçantë në rrugët e brendshme dhe dytësore</p> | <p>Adresuar 50%</p> | <p>Adresuar 75%</p> | <p>Adresuar 80%</p> |
| <p>Prioritet 8: Ngritja e politikave lokale për përfshirjen e të rinjve në vendimmarrje. Ngritja e Këshillit Rinor pranë Këshillit Bashkiak</p> | <p>Adresuar 50%</p> | <p>Adresuar 75%</p> | <p>Adresuar 90%</p> |
| <p>Prioritet 9: Informimi i komunitetit në lidhje me shërbimet e kujdesit shoqëror për grupet në nevojë. Përmirësimi i shërbimeve sociale pranë Njësisë Administrative</p> | <p>Adresuar 30%</p> | <p>Adresuar 50%</p> | <p>Adresuar 60%</p> |

Rekomandime

- Krijimi i incentivave për nxitjen e bizneseve nga të rinjtë siç mund të jenë inkubatorët e biznesit etj, të cilat rrisin aftësitë dhe mundësitë e të rinjve për zhvillimin e nismave dhe krijojnë premisa për hapjen e bizneseve prej tyre.
- Ngritja e një strategjie për nxitjen e biznesit dhe për pasojë nxitjen e punësimit.
- Kryerja me cilësi e investimeve në infrastrukturën rrugore duke pajisur rrugët me të gjitha elementet e saj duke përfshirë edhe sinjalistikën rrugore, e cila do çojë në rritjen e sigurisë në rrugë.
- Përmirësimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë.

Gjetjet nga Raporti i Pare i Monitorimit të Kontratës Sociale:

- Nga 9 prioritete të Kontratës Sociale vetëm 1 prioritet është adresuar plotësisht, 6 janë adresuar pjesërisht, ndërsa 2 nuk janë adresuar ende.
- Bashkia Kamëz ka zhvilluar incentiva për nxitjen e biznesit duke reduktuar me 50% taksat për bizneset e reja që hapen nga të rinjtë me qëllim krijimin e vendeve të reja të punës. Ndërkohë nga banorët kërkohet ngritja e një strategjie për nxitjen e biznesit dhe për pasojë nxitjen e punësimit.
- Bashkia Kamëz në paketën fiskale të vitit 2020¹² ka miratuar ndryshime në nivelin e taksave/tarifave lokale për kategoritë në nevojë duke aplikuar një ulje deri në 70%.
- Janë kryer disa investime në sistemin e ndriçimit në Njësinë Administrative Paskuqan dhe në mirëmbajtjen e ndriçimit për rrugën “Demokracia”, por banorët kërkojnë vijimin e këtyre investimeve edhe në rrugë të tjera dytësore në këtë Njësi Administrative.
- Në Njësinë Administrative Paskuqan, Bashkia ka kryer investime për shtimin e numrit të koshave të mbeturinave në 3 zona, ndërsa në Bathore ky investim është shtrirë në 3 lagje. Megjithë investimet e kryera banorët kërkojnë shtrirjen e këtyre investimeve edhe në lagjet e tjera si dhe shtimin e frekuencës së pastrimit.
- Me investim të qeverisë Shqiptare, në kuadër të programit të rindërtimit ka filluar puna për ndërtimin e 2 kopshteve; “Lidhja e Prizrenit” Paskuqan, me kapacitet 224 fëmijë, shkolla dhe kopshti “Halit Çoka” Bathore me kapacitet 200 fëmijë. Ndërkohë nga banorët kërkohet kryerja e investimeve edhe në ndërtimin e çerdheve të reja.
- Situata e problematikave me kanalizimet në Bathore, prioritet në lagjet 3 dhe 4, mbetet ende e pa adresuar nga Bashkia Kamëz. Është vetëm një investim në proces i cili shtrihet nga lagjia nr. 1 Bathore deri në lagjen Frutikulturë.
- Në Njësinë Administrative Paskuqan kanë nisur investimet në përmirësimin e infrastrukturës rrugore në 13 segmente dhe është investuar në mirëmbajtjen e 5 rrugëve të tjera. Nga banorët kërkohet cilësi në kryerjen e këtyre investimeve dhe shtrirja e tyre edhe në zona të tjera të Paskuqanit, kryesisht në rrugët dytësore.
- Në Bashkinë Kamëz është konstituar Këshilli Rinor mbi bazën e ligjit për rininë, i përbërë nga nxënës të 5 shkollave të mesme. Sipas takimeve me të rinjtë banorë të Kamzës atë kërkojnë që ky Këshill të jetë realisht funksional si dhe

¹² <https://www.vendime.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-Nr.-55.-Date-20.12.2019.pdf>

zhvillimin e politikave rinore të qëndrueshme dhe krijimin e kushteve dhe një mjedisi të sigurt social, shëndetësor dhe politik, për të rinjtë.

- Informimi i komunitetit në ldihe me shërbimet sociale bëhet nëpërmjet afishimit të në sportelet dhe ambientet e bashkisë, nëpërmjet vizitave në familje si dhe telefonatave dhe nëpërmjet faqes zyrtare të Bashkisë në rrjetet sociale. Banorët kërkojnë përmirësimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë.

Gjetjet nga raporti i Dytë i Monitorimit të Kontratës Sociale:

- Nga 9 prioritete të Kontratës Sociale vetëm 1 prioritet është adresuar plotësisht, ndërsa 8 janë adresuar pjesërisht në masën 60 – 80%.
- Gjatë vitit të parë të monitorimit, Bashkia Kamëz zhvilloi incentiva për nxitjen e biznesit duke reduktuar me 50% taksat për bizneset e reja që hapen nga të rinjtë me qëllim krijimin e vendeve të reja të punës. Ndërkohë gjatë vitit të dytë, Bashkia ka përjashtuar nga tarifat vendore të çdo subjekti të ri që hapet në territorin e bashkisë. Ndërkohë nga banorët kërkohet ngritja e një strategjie për nxitjen e biznesit dhe për pasojë nxitjen e punësimit.
- Bashkia Kamëz në paketën fiskale të vitit 2020 ka miratuar ndryshime në nivelin e taksave/tarifave lokale për kategoritë në nevojë duke aplikuar një ulje deri në 70%.
- Gjate këtyre dy viteve të monitorimit janë kryer disa investime në sistemin e ndriçimit në Njësinë Administrative Paskuqan dhe në mirëmbajtjen e ndriçimit për rrugën “Demokracia”, dhe në mirëmbajtjen e ndriçimit në disa rrugë dhe sipas banorëve këto investime kanë përmirësuar cilësinë e jetës, por ata kërkojnë vijimin e këtyre investimeve edhe në rrugë të tjera dytësore në këtë Nj. A.
- Në Nj. A. Paskuqan, Bashkia ka kryer investime për shtimin e numrit të koshave të mbeturinave në 5 zona, ndërsa në Bathore ky investim është shtrirë në lagjet 1, 2, 5, 6 dhe 7. Megjithë investimet e kryera banorët kërkojnë shtrirjen e këtyre investimeve edhe në shtimin e frekuencës së pastrimit.
- Me investim të qeverisë Shqiptare, në kuadër të programit të rindërtimit ka përfunduar puna për ndërtimin e 3 kopshteve: “Lidhja e Prizrenit” Paskuqan, me kapacitet 224 fëmijë, shkolla dhe kopshti “Halit Çoka” Bathore me kapacitet 200 fëmijë. Ndërkohë nga banorët kërkohet kryerja e investimeve edhe në ndërtimin e çerdheve.
- Gjatë vitit të parë të monitorimit filluan investimet në lagjen nr. 1 Bathore deri në lagjen Frutikulturë. Ndërkohë gjatë vitit të dytë, situata e problematikave me kanalizimet në Bathore është përmirësuar me anë të investimeve në përmirësimin e këtij shërbimi përkatësisht në lagjet 3,4,5 dhe 6 e që prek 4000 familje.
- Në Nj. A. Paskuqan kanë vijuar investimet e nisuar gjatë vitit të parë në përmirësimin e infrastrukturës rrugore në disa segmente dhe është investuar në mirëmbajtjen e tyre. Nga banorët kërkohet cilësi në kryerjen e këtyre investimeve.

- Që në vitin 2020, në Bashkinë Kamëz është ngritur Këshilli Rinor mbi bazën e ligjit për rininë, i përbërë nga nxënës të shkollave të mesme. Sipas takimeve me të rinjtë, banorë të Kamzës, atë kërkojnë që ky Këshill të ketë jetëgjatësi si dhe zhvillimin e politikave rinore të qëndrueshme dhe krijimin e kushteve dhe një mjedisi të sigurt social, shëndetësor dhe politik, për të rinjtë.
- Informimi i komunitetit në lidhje me shërbimet sociale bëhet nëpërmjet afishimit në sportelet dhe ambientet e bashkisë, nëpërmjet vizitave në familje dhe telefonatave e gjithashtu nëpërmjet faqes zyrtare të Bashkisë në rrjetet sociale. Banorët kërkojnë përmirësimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë.

Këshilli bashkiak dhe veprimtaria e tij

Këshilli Bashkiak Kamëz

Data e Konstituimit: 07.08.2019

Kryetar:

Përbërja: 41 anëtarë

Ndarja Gjinore: 43.9% gra, 51.1% burra

Këshilli Bashkiak Kamëz ka 6 komisione:

1. Komisioni i Financës, Taksave dhe Revizionimit.
2. Komisioni i Shëndetësisë, Arsimit, Rinisë, Sportit, Kulturës dhe Turizmit
3. Komisioni i Shërbimeve Publike, Bujqësi, Blektori dhe Pronave
4. Komisioni i Urbanistikës, Zhvillimit ekonomik dhe Infrastrukturës
5. Komisioni Juridik, Rend, Konfliktë
6. Komisioni për Barazinë Gjinore dhe Përfshirjen Sociale

Gjatë kësaj periudhe, SHIZI ka monitoruar mbledhjet e këshillit Bashkiak Kamëz në lidhje me vendimet të cilat prekin prioritetet e Kontratës Sociale.

Referenca

Faqja web e Bashkisë Kamëz <https://kamza.gov.al/>

Buxheti i vitit 2020, Bashkia Kamëz <https://kamza.gov.al/viti-2020/>

Buxheti i vitit 2021, Bashkia Kamëz <https://kamza.gov.al/viti-2021/>

Buxheti i vitit 2022, Bashkia Kamez: <https://kamza.gov.al/viti-2022/>

Paketa fiskale 2020 <https://ëëë.vendime.al/ëp-content/uploads/2020/05/Vendim-Nr.-55.-Date-20.12.2019.pdf>

Faqja në media sociale e bashkisë Kamëz <https://www.facebook.com/Bashkia-Kamez-108419860536646/>

Faqja në media sociale e Këshillit Bashkiak
<https://www.facebook.com/profile.php?id=100079531251291>

Aneks – Kontrata Sociale Kamëz

KONTRATA SOCIALE



PRIORITETET E KOMUNITETIT
BASHKIA KAMËZ
11.11.2019

Prioritet 1:

Zhvillimi i incentivave për nxitjen e biznesit duke reduktuar taksat për bizneset e reja që hapen nga të rinjtë me qëllim krijimin e vendeve të reja të punës.

Prioritet 2:

Krijimi i lehtësive në nivelin e taksave/tarifave lokale për kategoritë në nevojë.

Prioritet 3:

Adresimi me prioritet i rregullimit të ndriçimit dhe i mirëmbajtjes në Njësinë Administrative Paskuqan, sidomos në Lagjet Paskuqan 1 dhe 2.

Prioritet 4:

Kontrolli më i shpeshtë i shërbimit të pastrimit në Njësinë Administrative Paskuqan, në të dy lagjet, shtimi i numrit të koshave në Njësinë Administrative Bathore dhe Paskuqan si dhe shtimi i frekuencës së mbledhjes nga makinat e grumbullimit në të gjithë bashkinë Kamëz.

Prioritet 5:

Investimi në ngritjen e kopshteve dhe çerdheve të reja në Njësinë Administrative Bathore dhe Paskuqan si dhe largimi i kopshteve nga ambientet e shkollave: "Vëllazërimi", "Azem Hajdari" dhe "Isa Boletini"

Prioritet 6:

Adresimi me prioritet dhe zgjidhja e problemeve me kanalizimet në Njësinë Administrative Bathore, prioritet në lagjet 3 dhe 4.

Prioritet 7:

Investimi dhe adresimi për përmirësimin e rrugëve, trotuareve dhe sinjalistikës në Njësinë Administrative Paskuqan me një fokus të veçantë në rrugët e brendshme dhe dytësore.

Prioritet 8:


Ngritja e politikave lokale për përfshirjen e të rinjve në vendimmarrje. Ngritja e Këshillit Rinor pranë Këshillit Bashkiak.

Prioritet 9:

Informimi i komunitetit në lidhje me shërbimet e kujdesit shoqëror për grupet në nevojë. Përmirësimi i shërbimeve sociale pranë Njësive Administrative.



Shoqata për Integrimin e Zonave Informale


Greta Kokalari

Kryetari i Këshillit Bashkiak


Hysen Koldashi

Kryetar i Bashkisë Kamëz


Rakip Suli